# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-452069**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Grupi i strukturuar i qenve terrorizon dibranët: Kemi frikë të dalim |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1392248.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 11:50:52 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 17 shtator 2026, 11:47:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 17 shtator 2026, 11:46:00 UTC → 17 shtator 2026, 11:48:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `559d90c3cb4b4792ba4c86531adad8a4cd9cf5a7d45784dd601b99549b273fcb` |
| TEKSTI | `94cf6bb81756bacf5f2b62dcad82e8ebeff84784e2fce44056b23fe6c272e781` |
| PAMJA | `65bbf56c9bf94d4859df168bda6f700408b82c0b3ee2446aa95e4d203d825e71` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `7cc8bbb8a100b117b982e5e439a77a65524f853f0a8ab9753b028c910861fee1` |
| E MËPARSHMJA | `98a55740de7f4d31a6fa46bbc8cc27f1de8b24b767e7d842977407a004cadc6a` |
| RRËNJA MERKLE | `c459fbdf88f453b54a4131a2c6b72ae8533f09b2deef09d60e250bd91e1b553d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/7cc8bbb8a100b117b982e5e439a77a65524f853f0a8ab9753b028c910861fee1`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Grupi i strukturuar i qenve terrorizon dibranët: Kemi frikë të dalim

Shkruar nga: I Cani | Publikuar më: 17.09.2026, 13:47

Share Share



Një situatë shqetësuese raportohet në lagjen “Nazmi Rushiti” në Peshkopi, përballë Gjykatës së Peshkopisë, ku një numër i madh qensh endacakë janë kthyer në frikë të përditshme për banorët.

Një qytetar i është drejtuar JOQ Albania duke denoncuar situatën, ndërsa shprehet se banorët kanë frikë të dalin në orët e mbrëmjes për shkak të rrezikut të sulmeve dhe kafshimeve nga qentë.

Por problemi nuk mbaron këtu. Sipas denoncimit, koshat e mbeturinave janë vendosur në mes të trotuarit, duke ua vështirësuar kalimin këmbësorëve dhe duke i detyruar ata të kalojnë në rrugë.

Në një zonë pranë gjykatës, ku duhet të ketë siguri dhe kushte normale për banorët, qytetarët thonë se përballen me qen endacakë dhe trotuare të bllokuara nga mbeturinat.

Banorët kërkojnë ndërhyrje për të shmangur një situatë që mund të përfundojë me pasoja më të rënda, veçanërisht për fëmijët dhe të moshuarit.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat

ARTIKULL JOETIK?

TË NGJASHME

Më të fundit




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.